



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1000/3 Prot.

Tiranë, më 14.07.2025

V E N D I M

Nr. 165, Datë 14.07.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 151, datë 01.07.2025, e paraqitur nga znj. B.D¹ kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “etnisë”, “gjuhës” dhe “shtetësisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me email-in datë 05.07.2025, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Dëshiroj të regjistrohem në një program bachelor në Tiranë ku mësohet në gjuhën angleze. Disa universitete me programe vetëm në anglisht më thanë të kërkoja një ekuivalencë të provimit të maturës nga QSHA dhe QSHA përgjigjet si më poshtë: “Ju informojmë se ne kryejmë ekuivalentimin e diplomave të huaja që kanë përfunduar shkollën jashtë territorit shqiptar, ndërsa ju keni përfunduar shkollën e mesme në “Akademinë Botërore të Tiranës” (World Academy of Tirana), e cila është një shkollë që ushtron aktivitetin e saj brenda territorit të Shqipërisë, ekuivalentimin e së cilës ne nuk e kryejmë”. QSHA ka pranuar me shkrim se diskriminon studentët e huaj që studiojnë në Shqipëri, krahasuar me studentët e

¹ Znj. B.D është nënshtetase Australiane.

huaj nga pjesa tjetër e botës, kur ata regjistrohen në një universitet në Shqipëri. Ky diskriminim bazohet në vendndodhje, pasi kurrikula dhe vlerësimi IB janë ndërkombëtarë. MAS këshillon që duhet të jap provimin e maturës shtetërore të gjuhës shqipe, për të studiuar në gjuhën angleze në Shqipëri.

Studentët jo-shtetas në Shqipëri (p.sh, fëmijët e diplomatëve, investitorëve ose pensionistëve) e gjejnë veten të detyruar të shkojnë jashtë vendit, ku IB-ja e tyre njihet në çdo vend tjetër. Diplomat e tyre IB të lëshuara nga Gjeneva (nga shkolla shqiptare si WAT) trajtohen ndryshe, nëse fitohet jashtë vendit, edhe pse të gjitha janë identike.

Studentët e huaj që nuk mund të flasin shqip dhe dëshirojnë të studiojnë në Shqipëri në gjuhën angleze dhe që mbajnë një diplomë ndërkombëtare (Baccalaureate, IB Diploma), diskriminohen nëse kanë studiuar në Shqipëri, por jo diku tjetër në botë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe të udhëzohet MAS, që të përjashtojë nga provimet e maturës shtetërore të gjithë studentët e huaj me Diplomë IB dhe QSHA të ofrojë ekuivalentimin e maturës, në mënyrë të barabartë të gjithë studentëve të huaj me Diplomë IB.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkuftizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”*.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Në vitin shkollor 2024-2025, ankuesja ka ndjekur dhe ka përfunduar klasën e 12-të, në programin në gjuhën angleze, në shkollën e mesme “Akademia Botërore e Tiranës”. Ankuesja ka dashur të regjistrohet në një program studimi bachelor, në një institucion të arsimit të lartë në Tiranë, por i kanë kërkuar ekuivalentimin e diplomës së shkollës së mesme, dhe për këtë arsye i është drejtuar me email Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

QSHA me email-in datë 09.06.2025, i është përgjigjur si vijon: *“Ju informojmë se ne kryejmë ekuivalentimin e diplomave të huaja që kanë përfunduar shkollën jashtë territorit shqiptar, ndërsa ju keni përfunduar shkollën e mesme në “Akademinë Botërore të Tiranës” (World Academy of Tirana), e cila është një shkollë që ushtron aktivitetin e saj brenda territorit të Shqipërisë, ekuivalentimin e së cilës ne nuk e kryejmë”*.

Pala ankuese në ankesën objekt shqyrtimi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe ti rekomandojë, MAS dhe QSHA, përjashtimin nga detyrimi për dhënien e provimeve të maturës shtetërore për të gjithë studentët e huaj me Diplomë IB.

Ligji 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, parashikon se:

“Neni 1.

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

2. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

Neni 42.

1. Institucionet arsimore private dhe institucionet plotësuese private, krijohen dhe funksionojnë sipas këtij ligji, përveç rasteve kur ligji ka formulim të veçantë për institucionet arsimore publike si edhe akteve nënligjore të nxjerra në mënyrë specifike për to.

5. Shkollat private, në të cilat mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, ose që lëshojnë diploma të huaj apo të ngjashme me të, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në shkollat private të përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij neni, lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi, histori e kombit shqiptar dhe gjeografi e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

Neni 51.

Arsimi i mesëm i lartë përfundon me provimet e maturës shtetërore. Në provimet e maturës shtetërore nxënësit japin një numër lëndësh të përbashkëta dhe një numër lëndësh me zgjedhje. Të gjithë nxënësit kanë këto tre lëndë të përbashkëta: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë dhe një gjuhë e huaj. Lëndët me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve kombëtare të maturës shtetërore rregullohen me udhëzim të ministrit.

Neni 52.

1. Dokumenti i përfundimit të arsimit bazë është dëftesa e arsimit bazë, e cila lëshohet nga drejtori i shkollës pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë. Dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është diploma e maturës shtetërore, e cila lëshohet nga institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore.

3. Shkolla private e arsimit të mesëm të lartë e licencuar mund të lëshojë diplomë të një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të. Ministri përcakton procedurat e njësimit të këtyre diplomave”.

Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se:

“Neni 4.

1. Të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë e kanë të gjithë ata individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe të cilët plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi dhe nga institucionet e arsimit të lartë.

Neni 74.

1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në Udhëzimin e MAS, nr. 13, datë 30.06.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, parashikon se:

“1. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomës së arsimit të mesëm të lartë të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin parauniversitar, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QShA)...

6. QShA-ja dhe ZVAP-ja nuk shqyrtojnë aplikimet për rastet si më poshtë:

a) diploma/dëftesa të arsimit parauniversitar, të fituara në Republikën e Shqipërisë;

b) c)

Për rastet e përmendura në këtë pikë të Udhëzimit, aplikanti njoftohet zyrtarisht për mosshqyrtimin e aplikimit”.

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 584, datë 10.09.2014, “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy of Tirana)”, ka vendosur dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat “Akademia Botërore e Tiranës”.

Në këtë vendim, parashikohet se: “3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës”, mësimi do të zhvillohet në gjuhë të huaj anglisht. Në lëndët: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, histori e kombit shqiptar dhe gjeografi e Shqipërisë, mësimi do të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.

11. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të funksionojë në përputhje me legjislacionin shqiptar, që rregullon funksionimin e institucioneve arsimore private dhe të institucioneve arsimore plotësuese private, që zhvillojnë mësimin në gjuhë të huaj, në përputhje me konventat, traktatet dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Republika

e Shqipërisë, duke respektuar realitetin shqiptar, arritjet dhe traditat e shkollës kombëtare shqiptare”.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, rezulton se në ligjin 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”*, të ndryshuar, në nenin 51, ka të përcaktuar se arsimi i mesëm i lartë përfundon me provimet e maturës shtetërore. Ndërkohë, që në nenin 4, të ligjit 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”*, të ndryshuar, përcaktohet se individët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë të cilët plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, kanë të drejtë për të ndjekur arsimin e lartë.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se ankuesja ka ndjekur procesin mësimor në institucionin mësimor “Akademia Botërore e Tiranës”, por nuk i është nënshtruar provimeve të maturës shtetërore, dhe në këto kushte, rezulton se ankuesja nuk ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë, sipas përcaktimeve të nenin 51, të ligjit 69/2012, të ndryshuar.

Gjithashtu dhe QSHA-ja, referuar Udhëzimit 13/2023, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”*, nuk ka autoritetin për të shqyrtuar aplikimet për ekuivalentimin e diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore të Republikës së Shqipërisë.

Në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka asnjë dispozitë, në të cilën të parashikohet ekuivalentimi i diplomave të fituara në institucionet arsimore parauniversitare, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, në gjuhë të huaj, si dhe pranimi në programet e studimit të arsimit të lartë, për studentët të cilët kanë përfunduar procesin mësimor në një shkollë të mesme në Shqipëri, por nuk kanë janë të pajisur me diplomë të maturës shtetërore.

Në këtë kuptim dhe kërkesa e subjektit ankues për ekuivalentimin e përfundimit të shkollës “Akademia Botërore e Tiranës”, drejtuar Qendrës së Shërbimeve Arsimore, nuk mund të shqyrtohej nga këto të fundit, pasi kërkesa për ekuivalentim, është e panormuar nga legjislacioni shqiptar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është një institucion i ngarkuar nga ligji për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. (neni 21, i LMD) Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (neni 22, i LMD), ndërsa kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashikohen nga neni 32, i LMD.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë², në nenin 131, pika 1 geramat a) dhe c) ka sanksionuar se:
“1. Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me

² Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 dhe c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare”.

Në këtë mënyrë, baza dhe kufiri në ushtrimin e kompetencave për Komisionerin, janë Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Komisioneri ka kompetencë që të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar; të kryejë hetime kryesisht pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; por në çdo rast, ushtrimi i këtyre kompetencave bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Një ligj i cili vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, është një ligj i cili nuk është në përputhje me Kushtetutën, por gjykimin dhe vlerësimin për një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese, si i vetmi autoritet i autorizuar nga Kushtetuta për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, marrja në shqyrtim e një pretendimi, nëse një ligj është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një kompetencë që Kushtetuta i'a ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe se asnjë institucion tjetër shtetëror, përfshi edhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje, për të cilën nuk ka kompetencë dhe kur shqyrtimi i kësaj çështje është në kompetencën e një tjetër institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b), ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar shqyrtimit të mëtejshëm.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 151, datë 01.07.2025, të paraqitur nga znj. B.D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA